
ALBANIAN YOUTH IN MACEDONIA, THE FUTURE, EMIGRATION AND PREFERENCES

Abdlnaser SinaniUniversity of Tetovo, Tetovo, Macedonia, abdlnaser.sinani@unite.edu.mk

Abstract: This research aims to address and explain the perceptions, desires, attitudes and expectations of the Albanian youth in Macedonia on their future, prospects in the context of social and political changes in the country and at the global level. The research affects different dimensions of this age group in order to provide an overview of the vision and views of this generation, always in the aspect of country's prospects in the context of the great wave of migration to the developed Western countries. 220 young people aged 16 to 24 were interviewed, most of whom (86%) represent a relatively low level of satisfaction regarding the quality and standard of living, lack of prospects for building a career and a better life, meanwhile they have lost confidence in the institutions of the country and are desperate by politics so that most of them were ready to leave the country. This is a research on the interdependence of the social context, development or social progress, chances and opportunities of young people in the Republic of Macedonia, facing a dilemma: to stay in Macedonia (with low standard, poor, poor education, etc.) or to leave the country (with a safe job, career opportunities, and prospects for future planning). This research looks at the vital aspects of living of Albanian youth, chance for education and their future prospects. The research consists of ten modules: family values, education, aspirations for employment, prospects and careers, social welfare, religious beliefs, politics and inclusion, spare time and lifestyle. These indicators are also considered as the most important values of the Albanian youth in Macedonia. Reasons of emigration are: the desire to improve the standard of living, the aspiration to have more qualitative education and greater employment opportunities, which means a safer future. The unemployment rate among young people in Macedonia is 52.9%, ranking the country in the third place on the world list. Life in general and the standard of living from year to year has deteriorated, new jobs have been reduced, and unemployment and poverty have increased. This has also resulted in deteriorating interpersonal and interethnic relations in the country, losing hope for the future, especially among young people. Studies show that high unemployment rate has made young people in Macedonia to see their future more and more abroad. Although with a relatively high percentage of inclusion in secondary and university education, young people of this age group declare that education is an important value for them. Despite the preferences for education, the level of satisfaction with the current education system is very low. Only one-third of respondents are satisfied with the education system in the Republic of Macedonia.

Keywords: Albanian youth, Macedonia, prospects, emigration.

TË RINJTË SHQIPTARË NË MAQEDONI, E ARDHMJA EMIGRACIONI DHE PREFERENCAT**Abdlnaser Sinani**Universiti i Tetovës, abdlnaser.sinani@unite.edu.mk.

Abstrakt: Ky hulumtim ka për qëllim të trajtojë dhe shpjegojë perceptimet, dëshirat, qëndrimet dhe pritshmëritë e të rinjve shqiptar të Maqedonisë, mbi të ardhmen e tyre, perspektivat në kontekst të ndryshimeve sociale, shoqërore dhe politike në vend dhe në rafshin global. Hulumtimi prek dimensione të ndryshme të kësaj grupmoshe në mënyrë që të ofrojë një pasqyrë të vizionit dhe të pikpamjeve të kësaj gjenerate gjithnjë nga aspekti i perspektivave të vendit në konteskt të valës së madhe të emigrimit në vendet e zhvilluara perendimore. Janë anketuar 220 të rinjë nga mosha 16-24 vjet, pjesa dërmuese e të cilëve (86%) paraqesin një nivel realtivisht të ulët kënaqësie lidhur me cilësinë e dhe standardin jetësor, paperspektivat për ndërtim të një karriere dhe jetë më të mirë, ndërkohë kanë humbur besimin në institucionet e vendit dhe të dëshpruar nga politika sa që shumica e madhe e tyre deklarohen se janë të gatshëm të ikin nga vendi. Ky është një hulumtim mbi ndërvarësinë e kontekstit social, zhvillimit apo progresit shoqëror, shanseve dhe mundësitë të rinjve në R. e Maqedonisë, mes dilemës: të mbeten në Maqedoni (me standardë të ulët, të varfër, arsimim jocilësor, etj.), apo të largohen jasht vendit (me një punë të sigurtë, mundësi për karrierë dhe perspektiva për planifikimin e të ardhmes). Në këtë kërkim shqyrtohen aspektet qenësore të jetuarit të rinjve shqiptarë, shanset për shkollim, arsimimi dhe e ardhmja e tyre nga një kënd vështrimi i

perspektivave për të ardhmen. Hulumtimi përbëhet nga dhjetë module: vlerat familjare, arsimit, aspiratat për punësim, perspektiva dhe karriera, mirëqenia sociale, besimi fetar, politika dhe përfshirja, koha e lirë dhe stili jetësor. Këto indikatorë cilësohen edhe si vlerat e konsideruara si më të rëndësishmet nga të rinjtë shqiptarë në Maqedoni. Arsyet për të emigruar përfshijnë: dëshirën për të përmirësuar standardin e jetesës, aspiratën për të pasur shkollim më cilësor dhe mundësi më të gjera për punësim, që do të thotë për një ardhmëri më të sigurtë. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë në Maqedoni është 52,9%, që rendit vendin në pozitën e tretë në listën botërore. Jeta përgjithsisht dhe standardi jetësor nga viti në vit është përkeqësuar, janë zvogëluar vendet e reja të punës, është rritur papunësia dhe varfëria. Kjo ka rezultuar edhe me përkeqësimin e mardhënieve ndërnjerëzore dhe ndëretnike në vend, humbjen e shpresave për të ardhmen, sidomos të të rinjtë. Studimet provojnë se shkalla e lartë e papunësisë ka bërë që të rinjtë në Maqedoni të ardhmen e tyre gjithnjë e më shumë ta shohin jashtë vendit. Edhe pse me një përqindje relativisht të lartë të përfshirjes në arsimin e mesëm dhe universitar, të rinjtë e kësaj grupmoshe deklarojnë se arsimi është një vlerë e rëndësishme për ata. Edhe përkundër preferencave për arsim, niveli i kënaqësisë me sistemin aktual të arsimit është shumë i ulët. Vetëm një e treta e të anketuarëve janë të kënaqur me sistemin arsimor në R. E Maqedonisë.

Fjalë kyçe: të rinjtë shqiptarë, Maqedonia, perspektivat, emigracioni.

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është të hulumtoj mënyrën e të jetuarit, e ardhmja dhe preferencat e tyre të rinjve shqiptarë në R. e Maqedonisë, të ofrojë përgjigje të qarta mbi prirjet dhe qëndrimet të rinjve. Kriza e gjatë e tranzicionit, papunësia e lartë, mungesa e perspektivave ka reflektuar thellë në jetën dhe mënyrën e të menduarit dhe jetuarit të rinjve shqiptarë në Maqedoni. Si kornizë teorike dhe model për këtë kërkim janë marrë: Përceptimi mbi standardin jetësor, arsimimi, mundësitë e punësimit, trendi i emigrimit dhe besimi te institucionet politike të vendit, duke parashtruar një model hipotetik i mbështetur në qëndrime mbi vlerësimin e rezultateve të sjelljes, motivimi për të përmbushur indikatorët mbi sjelljen, karriera profesionale, apo kushtet e të jetuarit. Në këtë kërkim mostra përbëhet prej 220 individë nga moshë 16 vjeçe deri në moshën 24 vjet. Mostra është e qëllimshme, dhe në të kanë hyrë të rinjtë shqiptarë të R. Maqedonisë, sipas gjinisë, profesionit, degës së studimit apo shkollës. Në këtë kërkim shqyrtohen aspektet qenësore të jetuarit të rinjve shqiptarë, shanset për shkollim, arsimimi dhe e ardhmja e tyre nga një kënd vështrimi i perspektivave për të ardhmen. Ky është një hulumtim mbi ndërvarësinë e kontekstit social, zhvillimit apo progresit shoqëror, shanseve dhe mundësitë të rinjve në R. e Maqedonisë, mes dilemës: të mbeten në Maqedoni (me standardë të ulët, të varfër, arsimim jociësor, etj.), apo të largohen jashtë vendit (me një punë të sigurtë, mundësi për karrierë dhe perspektiva për planifikimin e të ardhmes). Rreth 76% e të rinjve shqiptarë të anketuar në këtë hulumtim, dëshirojnë të shkojnë jashtë vendit, sikur t'u jepet mundësia. Arsyet për të emigruar përfshijnë: dëshirën për të përmirësuar standardin e jetesës (56%), aspiratën për të pasur shkollim më cilësor dhe mundësi më të gjera për punësim (68%), që do të thotë për një ardhmëri më të sigurtë. Shkalla e papunësisë tek të rinjtë në Maqedoni është 52,9%, që rendit vendin në pozitën e tretë në listën botërore, (hulumtimi i "Papunësia e të rinjve në R. e Maqedonisë", i realizuar nga Fondacioni "Fridrih Ebert") Hulumtimi gjithashtu ka treguar se më shumë se 60% e të rinjve mbi 18 vjet konsiderojnë se vështirë gjendet vendi i punës në vend.

1. TRANZICIONI I GJATË –GJENDJE E PADURUESHME

Përshkrimi i shkurtër i periudhës së gjatë të tranzicionit në R. e Maqedonisë pas fillimit të proceseve të demokratizimit (1990) të vendit deri në ditët e sotme (2018), mund të ishte: anketë për qytetarët në të gjitha segmentet (politikë, ekonomi, kulturë, të ardhme). Jeta përgjithsisht dhe standardi jetësor nga viti në vit është përkeqësuar, janë zvogëluar vendet e reja të punës, është rritur papunësia me rrjedhojë rritja e varfërisë. Kjo ka rezultuar edhe me përkeqësimin e mardhënieve ndërnjerëzore dhe ndëretnike në vend, humbjen e shpresave për të ardhmen, sidomos të të rinjtë. Punësimi bëhet, jo sipas meritave apo aftësive dhe vendit të punës, por në bazë të klientarizmit, ndikimit partiak dhe farefisnisë. Partizim i plotë i shoqërisë, lënia pas dore e kuadrove të aftë dhe profesionalë, vendet e të cilëve i zënë aktivistët partiak. Shumica e të punësuarëve në administratën komunale dhe atë shtetërore, nuk punojnë në vendet e punës sipas kualifikimit të tyre.

Lidhjet personale dhe politike renditen në vendin e parë si faktor për gjetjen e punës, ndërsa nuk është rroga apo puna sipas profesionit për pranimin e punës, si ndodh zakonisht, porse të rinjve shqiptar u mjafton vetëm një vend pune në administratën shtetërore. Pjesa më e madhe e të rinjve rekomandojnë që shkalla e lartë e papunësisë ka bërë që të rinjtë në Maqedoni të ardhmen e tyre gjithnjë e më shumë ta shohin jashtë vendit. Përderisa institucionet shtetërore nuk kanë informacion për numrin e të rinjve që janë larguar nga vendi, madje nuk dihen as profilet e

atyre, të cilët janë larguar për gjetur punë në ndonjë nga vendet e Bashkimit Evropian, në bazë të të dhënave të Bankës Botërore, shkalla e papunësisë në mesin e të rinjve në Maqedoni, është mbi 50 për qind. Përpos asaj se janë shkaqet ekonomike, rinia nga Maqedonia largohet edhe për arsye se puna e tyre, qoftë ajo fizike apo intelektuale, nuk paguhet mirë, përkatësisht nuk vlerësohet aq sa duhet. Sa i përket procesit të arsimit, mungojnë kushtet sa i përket cilësisë, dhe nga ana tjetër edhe pse dikush përfundon studimet me sukses të lartë, për shkak të nepotizmit dhe influencës politike, nuk arrin të punësohet. Kjo i dekurajon të rinjtë për ta parë perspektivën në vend. Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për numrin e të rinjve të larguar, por supozohet se dhjetë vitet e fundit fluksi i largimit të kësaj grupmoshe në vendet perendimore, nga ajo që shihet apo ndëgjohe, është e qartë se vendi boshatiset. Pikërisht ky grup duhet të jetë në fokus të politikave të autoriteteve udhëheqëse të vendit për punësim, sepse kështu është në vendet e zhvilluara demokratike. Kjo ngaqë pasivizimi i këtij kapitali njerëzor, paraqet kërcënim apo rrezik, jo vetëm për të ardhmen e kësaj kategorie, por për mbarë shoqërinë, sepse bëhet fjalë për një shifër të lartë të të rinjve përkatësisht rreth 25 për qind e tyre. Pra, duhet bërë çmos që këta të rinj të kthehen në tregun e punës përmes aftësisë së tyre në lëmi të caktuara.

Sidomos në dekadëshin e fundit, ka një rritje ekstreme në migrimin e të rinjve me arsim të lartë të përfunduar, gjegjësisht migrimi i njohur si “migrimi i trurit”, domethënë kategoria e të rinjve që kërkojnë punë jo fizike. Mendohet se pikërisht ky lloj i migrimit shkakton gjendje alarmante për ardhmërinë e shtetit dhe në këtë pikë shteti duhet të marrë përmasa serioze për parandalimin e këtij fenomeni. Në këtë kontekst, implementimi i meritokracisë, gjegjësisht punësimet në bazë të meritës e jo lojalitetit partiak është një ndër hapat më të rëndësishme që rinisë t’i kthehet shpresa për perspektivë në vend. Ata (85%) theksojnë se ka një jopërputhshmëri mes asaj se çka ofrojnë universitetet dhe çka në të vërtetë kërkon tregu i punës. Sipas tyre, një nga sfidat më të mëdha të Maqedonisë si shtet, do të jetë harmonizimi i kërkesave mes sektorit të biznesit dhe fakulteteve në funksion të ngritjes së një perspektive të qëndrueshme për të rinjtë. Edhe të rinjtë të cilët janë të punësuar në administratën publike janë të gatshëm të largohen nga shteti, kryesisht për shkak të punës apo përmirësimit të gjendjes financiare.

2. REZULTATET E KËRKIMIT

Hulumtimi përbëhet nga dhjetë module: vlerat familjare, arsimit, aspiratat për punësim, perspektiva dhe karriera, mirëqenia sociale, besimi fetar, politika dhe përfshirja, koha e lirë dhe stili jetësor. Këto indikatorë cilësohen edhe si vlerat e konsideruara si më të rëndësishmet nga të rinjtë shqiptarë në Maqedoni, të cilave u paraprinë familja, besimi fetar, punësimi, perendimi, arsimit, miqësia, ata deklarohen altruistë, tolerantë dhe me mjaftë korrektesë, pas tyre rradhiten perendimi (si alternativë me perspektivë) prestizhi shoqëror, moda dhe pasuria. (tabela 1)

Të rinjtë që ishin pjesë e këtij hulumtimi pohojnë se besimin më të lartë e kanë te familja dhe feja besimi fetar si dy institucionet më të rëndësishme shoqërore. Përrjashtuar studentët të cilët studiojnë jashtë vendlindjes së tyre, pothuaj të gjithë të rinjtë jetojnë në bashkësi me familjen e tyre.

Tabela 1. Renditja e vlerave e të rinjve shqiptarë

Vlera	Përqindja
Familja	88
Feja	76
Punësimi	54
Perendimi	54
Arsimi	54
Miqësia	47
Politika dhe përfshirja	45
Prestizhi shoqëror	36
Moda dhe pasuria	32
Mirëqenia sociale	32
Koha e lirë dhe stili jetësor (ushqimi, aktiviteti fizik, veshja, aktivizmi qytetar)	27

Numri më i madh i të anketuarëve (76%) janë të gatshëm të emigrojnë jashtë vendit sapo t’u jepej rasti, arsyet për ikur jashtë përfshijnë: standardi më i lartë, siguria për të ardhmen, punësimi dhe jeta më e mirë. Edhe pse me një përqindje relativisht të lartë të përfshirjes në arsimim e mesëm dhe universitar, të rinjtë e kësaj grupmoshe deklarojnë se arsimit është një vlerë e rëndësishme për ata. Edhe përkundër preferencave për arsim, niveli i kënaqësisë me sistemin aktual të arsimit është shumë i ulët. Vetëm një e treta e të anketuarëve (33%) janë të

kënaqur sistemin arismor në R. E Maqedonisë. Treguesitë kryesorë të gjendjes së vështirë në arsim ata e mbështesin te politizimi dhe partizimi i arsimit, me rrjedhojë kuadër mësimor me shkathhtësi të ulët profesionale, mungesa e financave, jopërputhja e profileve arsimore me nevojat e biznesit. Faktorë tjerë, si blerja e notave, mungesa e teksteve shkollore, disproporcioni mes asaj që mësohet në shkollë dhe nevojave të profesionit, po aqë ndikojnë negativisht në cilësinë arsimore. Është tregues indikativë e dhëna sipas së cilës ndjekja e kurseve dhe trajnimeve private është një praktikë e përhapur në të gjitha nivelet arsimore. Rreth 50% e të rinjve të moshës 16-24 vjeç thonë se kanë ndjekur apo akoma ndjekin kurse jashtë shkollës, në të shumtën e rasteve kurset mbahen nga pedagogët e rreulltë në shkolla apo universitete. Krahas nxënies së njohurive të reja, shkathhtësi plotësuese, por edhe lehtësia për të kaluar një provim ose për të marrë një notë më të mirë, nëse personi që mban trajnimin privat është gjithashtu edhe mësimdhënës në shkollë. Rreth 43 % e pjesëmarrësve në hulumtim deklarojnë që blerja e notave është një dukuri e zakonshme në shkollat tona. Të gjithë e dinë që blerja e notave është një fenomen i zakonshëm, ishte përgjigjia më e shpeshtë, në këtë pyetje.

Niveli i punësimit është i ulët ndër të rinjtë shqiptarë në Maqedon. Gjysma e të rinjve mbi moshën 18 vjeçare nuk janë të punësuar, (Papunësia e të rinjve në R. e Maqedonisë”, që e realizoi Fondacioni “Fridrih Ebert/2016). Vendi i punës në administratën publike është sektori më i preferuar për punësim dhe njëheritë punëdhënësi më i madh në Maqedoni.

Të rinjtë e anketuar mendojnë se lidhjet, apo miqësia dhe ndikimi politikë, janë faktori më i rëndësishëm për të gjetur punë. Rreth 50% e të rinjve i përmendin ato si faktorin kryesor për t’u punësuar. Të rinjtë kanë humbur besimin në institucionet shtetërore, si paritit politike, qeveria apo policia dhe gjykatat. Institucionet pak më të besuara janë avokati i popullit, dhe deri diku Televizioni publike dhe prokuroria. Ndërkaq pjesa më e madhe mostrës deklarohet e shqetësuar për varfërinë (84%), konfliktet ndëretnike (52%), papunësinë (47%), emigracionin (51%), ndotjen e ambientit (46%), rënies së cilësisë së arsimit (36%)

Përgjithsisht të rinjtë shqiptarë në Maqedoni nuk janë optimistë për përmirësimin e gjendjes së rëndë të vendit si në ekonomi ashtu edhe në politike dhe frikohen për të ardhmen e vendit dhe perspektivat e tyre.

LITERATURA

- [1] Jan Wright & Judith Laverty. (2010). Young people, physical activity and transitions: *Faculty of Education - Papers*.
- [2] [Sallis JF](#), [Prochaska JJ](#), [Taylor WC](#).(2000). A review of correlates of physical activity of children and adolescents: [Med Sci Sports Exerc](#). 2000 May;32(5):963-75.
- [3] “Papunësia e të rinjve në R. e Maqedonisë”, Fondacioni “Fridrih Ebert/2016.
- [4] Strategjia për zhvillimin e sportit në R. e Maqedonisë.
- [5] Strategjia kombëtare kundër varfërisë dhe përjashtimit social në R. e Maqedonisë 2010-2015.
- [6] “Papunësia e të rinjve në R. e Maqedonisë”, / Fondacioni “Fridrih Ebert/2016